



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2022:231131

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05605765

P.nr.470/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm - Divizioni penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica dhe bashkëpunëtorin profesional Izet Hyseni, në çështjen penale kundër të akuzuarit: F. R., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.4255/2022 datë 31.10.2022, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur më dt.22.04.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit – Menduhi Kastrati, si dhe të akuzuarit, në të njëjtën mori publikisht aktgjykimin, ndërsa me datë 23.04.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F. R., nga i ati H. dhe nëna R., e vajzërisë H., i lindur më datë, me vendbanim në fshatin Sh., rruga "I. D.", Komuna e Podujevës, me numër personal të identifikimit:....., ka të kryer pesë vite të shkollës fillore, profesioni i pa punë, i martuar baba i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike-financiare, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

S e p s e,

Me datën 31.8.2022 rreth orës 09:30 në lagjen O. në fshatin Sh. Komuna e Podujevës me dashje e në bashkëkryerje i shkaktojnë lëndime te lehta trupore me pasojë të përkohshme në shëndet të dëmtuarit A. O. në atë mënyrë që: ditën kritike për shkak të mosmarrëveshjeve te mëhershme mes vete ne lidhje me blerjen e një ngastre nga i dëmtuari, të pandehurit shkojnë tek shtëpia e të dëmtuarit dhe aty fillimisht i pandehuri F. e kap për fyti e pastaj se bashku me te pandehurin Fadil fillojnë ta godasin me grushte dhe shqelma duke i shkaktuar kontusion te orbitës se majtë, kontusion të kafazit të kraharorit dhe gjurit te djathtë te kualifikuara si lëndime te lehta trupore me pasoje te përkohshme në shëndet.

- me çka ne bashkëkryerje ka kryer vepër penale "Lëndim i lehte trupor" nga neni 185 par 1 nën-par 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 17, 31, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe 185 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 322, 364, 365, 368, 369, 449 dhe 452 të KPP-së, e:

G J Y K O N

- I. Të akuzuarin dënim me kusht, ashtu që i shqipton dënim me gjobë në shumën prej 300.00€ (treqind/euro), i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit prej 1 (një) viti nuk kryen veprë të re penale, pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë.
- II. Gjykata e liron të akuzuarin nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale ngase pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit ose të personave që ai detyrohet ti mbështesë materialisht.
- III. Përfaqësuesi i të dëmtuarit- djali F. O. në seancën e shqyrtimit fillestar ka hequr dorë nga realizimi i kërkesës pasurore – juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën, PP.II.nr.4255/2022 datë 31.10.2022, kundër të akuzuarve: F. R. dhe F. R., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor më datë 22.04.2024 gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit Menduhi Kastrati nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, përfaqësuesi i familjes së të dëmtuarit – të ndjerit A. O. djali F. O., si dhe i akuzuari, ndërsa nuk ka prezantuar i pandehuri F. R. për të cilin sipas informatës së stacion policor në Podujevë, thuhet se i njëjti gjendet në Gjermani.

Pas marrjes se mendimit nga palët ne procedure, prokurorit të shtetit si dhe të akuzuarit F. R., gjykata duke u bazuar në nenin 36 par.2. të KPRK-së, ka bërë veçimin e procedurës penale ndaj të pandehurit F. R. për shkak të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të cilin vazhdon procedurë me nr. te ri, ndërsa shqyrtimin gjyqësor ka vazhduar ndaj te pandehurit F. R..

I akuzuari në seancën e shqyrtimit gjyqësor, lidhur me veprën penale që i vihet në barrë deklaroi: E pranoj fajësinë, është e vërtet se me të dëmtuarin tani të ndjerin ka ndodhur një mos marrëveshje e vogël, me të dëmtuarit jemi rregulluar, tani nuk kemi asnjë problem, jemi fqinjë të mirë, kërkoj nga gjykata një dënim sa më të lehtë, pasi që jam i pa punë, prind i katër fëmijëve, është hera e parë që jam në gjykatë.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj gjykata konform nenit 322

të KPP-së, ka dëgjuar prokurorin e shtetit dhe të dëmtuarin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ndër të tjera ka deklaruar: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që është në përputhje me dispozitat ligjore të KPP-së, dhe gjenë mbështetje në shkresat e lëndës.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar F. O., djali i të dëmtuarit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, me të njëjtin jemi pajtuar, nuk kërkoj kompensim dëmi, dhe nuk kërkoj që të dënohet.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, përfaqësuesit të familjes së të dëmtuarit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 322 par.1 të KPP-së dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor, andaj Gjykata konform nenit 322 par.4 të KPP-së, ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi: Meqenëse i akuzuari u deklaruar se pranon fajësinë për veprën penale që akuzohet, kërkojmë nga gjykata që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit pranimi i fajësisë të merret si rrethanë lehtësuese, po ashtu pendimi i të akuzuarit për vepër penale, përmisimi i raporteve familjare me familjen e të dëmtuarit tani të ndjerit, fakt i vërtetuar nga përfaqësuesit e të ndjerit, të cilët deklaruan se me të pandehurin nuk kanë asnjë problem dhe kanë raportet tani të përmisuara.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit në fjalën përfundimtare deklaroi: Me të pandehurin jemi pajtuar, me të njëjtin nuk kemi asnjë problem, nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale dhe nuk kërkojmë kompensim dëmi.

I pandehuri në fjalën përfundimtare deklaroi: Më vjen keq për veprën penale që ka ndodhur, kërkoj nga gjykata një dënim sa më të butë për shkak të kushteve të dobëta ekonomike.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethanat të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu i njëjti është penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, për çka të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethanat lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari në fillim të shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, raportet tani të rregulluara me familjen e tani ndjerit – të dëmtuarit, deklarimin e përfaqësuesit të familjes së dëmtuar, i cili deklaroi se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti. Andaj, gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale

të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 449 lidhur me nenin 452 par.1 të KPP-së, dhe vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi lirimin nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale për të akuzuarin, është marrë në kuptim të nenit 452 par. 4 KPP-së, ngase pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të pandehurit ose të personave që ai detyrohet ti mbështesë materialisht.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal
P.nr.470/2022 me dt.23.04.2024

G j y q t a r i

Minir Hoti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.